



# **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e teknologjisë së informacionit ushtruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**PËR**

**AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

**NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Tiranë, korrik 2024**

## PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	4
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
1.	Objektivat dhe qëllimi	5
2.	Identifikimi i çështjes	5
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	5
4.	Përgjegjësitë e audituesve	5
5.	Kriteret e vlerësimit	6
6.	Standardet e auditimit	6
7.	Metodat e auditimit	6
8.	Dokumentimi i auditimit	6
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	<b>Qeverisja në teknologjinë e informacionit</b>	7-13
a	Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK	
2.2	<b>Siguria e informacionit</b>	13-18
a	Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet	
b	Siguria e të dhënave, ndërveprimi dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit	
2.3	<b>Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output</b>	18-31
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>32-38</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga data 22.01.2024 deri në 22.04.2024.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë, mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimit e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në KQZ, është pjesë e Planit Vjetor 2024 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që janë zhvilluar në KQZ.

Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1137/2, me datë 22.01.2024, ndryshuar me shkresën nr.1137/3, datë 28.03.2024.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

*Paraqitja e gjetjeve kryesore:*

- Nga auditimi konstatohet se, në të dy periudhat zgjedhore 2021 dhe 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në Vendimin e Komisionit Rregullator, ka kërkuar të dhëna mbi foton e çdo zgjedhësi, si një informacion i depozituar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, megjithëse kjo e dhënë nuk është përcaktuar si përbërës zgjedhorë në Kodin Zgjedhor.

- Nga auditimi konstatohet se në ndryshimet e udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, publikuar me nr. 189, datë 4.10.2022, të dhënat personale që KQZ ka marrë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, kishin mbetur të njëjta.

Me dërgimin e Projekt Raportit të Auditimit nga KLSH, KQZ i ka përcjellë Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, konstatimin e KLSH-ës për të cilin janë marrë masa duke përditësuar Aneksin I të udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020. Për elementët e zgjedhorë të shtuar në këtë Aneks u konstatua se, jo vetëm nuk është ruajtur emërtimi sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor, por është shtuar dhe Foto e Votuesve, megjithëse ky element nuk është përbërës zgjedhorë sipas këtij neni.

- Nga auditimi mbi strukturën e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, u konstatua se nuk ka në strukturën e saj një pozicion dhe detyra të përcaktuara për Sigurinë e të Dhënave, në kushtet kur institucioni mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive. Masat organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesimin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, rrjedh si detyrim i nenit 27/pika 1 në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Nga auditimi mbi sistemin e Platformës për Raportimin Financiar u konstatua se në këtë sistem:

- Nuk lejohet shkarkimi i raporteve nga përdorues të KQZ-s, që kanë të drejta miratimi përpara se ata ti miratojnë ato;

- Nuk mundësohet gjenerimi i raporteve në format Excel apo formatet të tjera të përdorshme dhe të nevojshme me qëllim realizimin e statistikave të ndryshme;
- Nuk është bërë ende konfigurimi i rolit auditues në sistem;
- Drejtoria e IT-së në KQZ nuk ka njohuritë dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi dhe nuk është parashikuar marrëveshje e nivelit të shërbimit.

*Paraqitja e rekomandimeve kryesore:*

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Rregullator të marrin masa për të shtuar foton si përbërës zgjedhor në nenin 45 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, nisur nga fakti që ky element vlerësohet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për identifikimin e votuesve;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të përcjellë tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrinë e Brendshme, kërkesën për përditësimin e udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020, duke pasqyruar të gjithë elementët specifikë të identifikuar si përbërës zgjedhor sipas përcaktimeve ligjore të nenit nr.45 të Kodit Zgjedhor, por jo foton për aq kohë sa ky elementë nuk është parashikuar si përbërës zgjedhor.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të marrë masa për përcaktimin e detyrave specifike në lidhje me Sigurinë e të Dhënave që mbledh, ruan dhe përpunon, me qëllim dokumentimin e masave tekniko-organizative për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret të tjera në fuqi;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për sistemimin e problematikave të konstatuara në Platformë Elektronike të Raportimit Financiar - PERF, me qëllim përmirësimin e funksionaliteteve të ndërtuara aty që i shërbejnë auditimit dhe ofrimit të të dhënave në përmbushje të detyrimeve mbi transparencën e financimit të partive politike ndaj grupeve të interesit.

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në, ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, vlerësojmë se teknologjia e informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është konsideruar si një hap kritik drejt sigurisë dhe besueshmërisë së procesit zgjedhor, por nevojiten të merren masa për të qenë në përputhje me standardet e sigurisë së informacionit. Për përmirësimet e mëtejshme të sistemeve të IT-së në KQZ, nevojitet të merren masa për përmirësimin e kushteve të dhomës së serverave, për të ndërtuar një infrastrukturë qendrore të teknologjisë së informacionit në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Marrja e masave për hartimin dhe miratimin e Politikave / Procedurave të Sigurisë së Informacionit, me qëllim njohjen dhe minimizimin e riskut të incidenteve që mund të sjellin humbje, tjetërsim apo transferim të informacionit kofidencial që akseson dhe administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij. Gjithashtu marrjen e masave për ndërtimin dhe administrimin e një infrastrukturë të qendëruar të aksesimit në rrjet nga përdoruesit nëpërmjet implementimit të *Active Directory*, si një nga praktikat më të mira e parashikuar gjithashtu në standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe që ndikon në sigurinë e të dhënave qendrore dhe lokale të përdoruesve.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 1137/2 prot., datë 22.01.2024, ndryshuar me shkresën nr.1137/3, datë 28.03.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 22.01.2024 deri më datë 22.04.2024, në subjektin “Komisioni Qendror I Zgjedhjeve”, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C., përgjegjës grupi;

2. K. S., audituese;
3. R. K., auditues.

## **1. Objektivat dhe qëllimi**

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në KQZ, nga data 22.01.2024 deri më datë 22.04.2024. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Objekti i Auditimit TIK* është përcaktimi nëse sistemet e teknologjisë së informacionit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, mbrojnë asetet e informacionit; ruajnë integritetin e të dhënave; sigurojnë disponueshmërinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe mbështeten në kontrole të duhura.

*Qëllimi i Auditimit TIK* është vlerësimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

## **2. Identifikimi i çështjes**

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1137/2 Prot, datë 22.01.2024:

1. Qeverisja në teknologjinë e informacionit
  - a. Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.
2. Siguria e informacionit
  - a. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet
  - b. Siguria e të dhënave, ndërveprimi dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.
3. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output.

## **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

KQZ është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

Misioni i KQZ është të mbështesë zhvillimin e kulturës zgjedhore, të ofrojë aksesueshmëri në mënyrë të barabartë në shërbime efektive e bashkëkohore për zgjedhësit dhe palët në proces, si dhe të zhvillojmë procese zgjedhore të sigurta në përputhje me standardet ndërkombëtare të besueshmërisë.

## **4. Përgjegjësitë e audituesve**

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi KQZ mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2023, në drejtim të çështjeve dhe zgjidhjeve informatike që janë implementuar në sistemet informatike.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr.1137/2 Prot., datë 22.01.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon institucioni nën auditim si dhe legjislacionin për Teknologjinë e Informacionit në vendin tonë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

*Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”;
- Ligji nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”;
- Ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Ligji nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”, etj;
- Rregulloret përkatëse të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Rregulloret e miratuara nga CESK;
- Standardet TIK, etj.

## 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

## 7. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit;
- Shqyrtimi i dokumenteve ligjorë, për sistemet informatike që institucioni disponon;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi, etj.

## 8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

KQZ është një organ publik, i cili, brenda autoritetit të tij, ushtron kompetenca administrative në mënyrë të pavarur nga organet e tjera publike e shtetërore dhe vepron në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2020, KQZ ka pasur si objektiv përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe përgjatë viteve 2021-2023, ka vënë në funksion sisteme dhe pajisje si më poshtë:

##### Për zgjedhjet e vitit 2021:

- Sisteme/pajisje të teknologjisë së informacionit për identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin pas zgjedhor të tyre;
- Projekti pilot i votimit dhe numërimit elektronik të votave (PEVN);
- Përditësimi i sistemit aplikativ të informacionit parazgjedhor dhe Sistem i integruar i menaxhimit të informacionit zgjedhor;
- Shërbim për sistemin e regjistrimit dhe transmetimit online në VNV;
- Sistem video monitorimi në qendrat e votimit;

##### Për zgjedhjet e vitit 2022:

- Përditësim i sistemit aplikativ të informacionit zgjedhor;
- Përshtatje e aplikacionit mobile të menaxhimit të zgjedhjeve të pjesshme vendore;
- Shërbim dhe suport për pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI);
- Shërbim për ngritjen e sistemit për regjistrimin, transmetimin online të procesit të regjistrimit të votave (VNV);
- Shërbim suport IT dhe logjistike për pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik të votave (PEVN).

##### Për zgjedhjet e vitit 2023:

- Shërbime (logjistike dhe soft) për pajisjen e identifikimit elektronik (PEI);
- Implementimi i projekt pilot të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN);
- Shërbim për sistemin e regjistrimit dhe transmetimit online në VNV;
- Infrastruktura TIK KQZ;
- Modulet për modernizmin e shërbimeve të KQZ;
- Shërbime të administrimit të të dhënave parazgjedhore dhe të rezultateve zgjedhore;
- Shërbime Live Vote 2023 (module) IEMIS.

#### 2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

##### 2.1 Qeverisja në teknologjinë e informacionit

- a. Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

Në zbatim të pikës 1.a “Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rregullorja e brendshme e institucionit;
- Struktura e përgjithshme organizative e miratuar e institucionit;
- Lista e të gjithë punonjësve në TI sipas kategorisë, hierarkisë, pozicionit të punës në strukturë si dhe përshkrimet e punës sipas akteve rregullativë në fuqi;
- Organigrama;
- Aktet rregullativë që lidhen me sistemet dhe veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit;

- Gjithashtu grupi i auditimit mblodhi informacione duke zhvilluar pyetësorë e intervista me stafin e KQZ dhe mbi informacionin e mbledhur u zhvilluan analizime, etj.

Me vendimin nr. 74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e kuvendit nr. 67/2020”, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, është miratuar struktura dhe organigrama e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një numër total prej 95 punonjësish.

Struktura e KQZ, është e përbërë nga:

- a) Komisioneri;
- b) Nën/Komisioneri;
- c) Komisioni Rregullator;
- d) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve;
- e) Kabineti;
- f) Sektori i Auditit të Brendshëm;
- g) Sekretar i Përgjithshëm;
- h) Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

*Nga auditimi mbi strukturën e KQZ, u konstatua se nuk ka në strukturën e saj një pozicion dhe detyra të përcaktuara për Sigurinë e të Dhënave, në kushtet kur institucioni mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive. Masat organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesimin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, rrjedh si detyrim i nenit 27/pika 1 në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Konstatimi i mësipërm mbart riskun e aksesit të pa autorizuar në të dhënat personale që mbledh dhe përpunon KQZ-ja.

## **Strategjia, procedurat dhe rregulloret në TIK**

Strategjia për aplikimin e TIK në KQZ, është e parashikuar si pjesë e “Planit strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë: një instrument për përmirësimin e institucionit 2022 – 2026”, e miratuar me Vendimin nr. 172 datë 14.06.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e plani strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë, 2022 – 2026”, në objektivin strategjik “Sigurimi i infrastrukturës transparente për nxitjen dhe pjesëmarrjen e mërgatës në zgjedhje, përpunimin e rezultateve të besueshme zgjedhore dhe krijimin e një mjedisi elektronik për zhvillimin e zgjedhjeve”. Në këtë plan strategjik citohet se: “Në përfundim, KQZ-ja ka nevojë për një strategji të përgjithshme informatike, që duhet zbatuar brenda një afati të arsyeshëm, domethënë, brenda një periudhe afatshkurtër dhe afatmesme. Në tabelat e mëposhtme vërehet përmendja disa herë e inovacioneve informatike, jo vetëm te tabela që i kushtohet Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, çka tregon fushëveprimin dhe rëndësinë faktike që kanë këto instrumente.”

Bazuar në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të TI dhe praktikat më të mira të fushës; Vendimi nr. 172, datë 14.06.2022 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e plani strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë, 2022 – 2026”, konstatohet se plani strategjik nuk është përditësuar ku të jenë reflektuar ndryshimet që ka pësuar struktura e KQZ me vendimin nr. 74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë. Gjithashtu, nisur me zhvillimet teknologjike që KQZ ka implementuar së fundmi konstatohet se, nuk ka një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit, ku të adresohen qartë objektivat e institucionit, kapaciteti aktual i TI për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve, duke marrë në konsideratë ekzistencën e



infrastrukturës së IT, investimeve, modelin e ofrimit, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët, për të mbështetur objektivat e institucionit. Mungesa e një plani strategjik mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme të teknologjisë së informacionit që mbështesin veprimtarinë e institucionit.

### Verifikim i politikave dhe procedurat në TIK

Aktualisht, KQZ e ushtron aktivitetin e tij mbështetur në rregulloren “Për organizimin, funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, miratuar me Urdhrin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 181, datë 06.04.2021.

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit në KQZ, verifikoi Rregulloren e Brendshme të institucionit si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje, pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara si dhe nga praktikat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Me vendimin nr.21, datë 26.02.2024 është miratuar rregullorja e re “Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të komisionit qendror të zgjedhjeve”, në të cilën janë reflektuar disa ndryshime dhe në Drejtorinë e Logjistikës dhe Dixhitalizimit.


Nga auditimi u konstatua se, përshkrimet e punës për punonjësit e Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit nuk janë reflektuar ndryshimet që parashikohen në rregulloren e miratuar me vendimin e Komisionerit nr.21, datë 26.02.2024 “Për miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të komisionit qendror të zgjedhjeve”.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Drejtorinë e Logjistikës dhe Digjitalizimit ka reflektuar ndryshimet në përshkrimet e punës së punonjësve të kësaj Drejtorie sipas konstatimeve të grupit të auditimit gjatë fazës së auditimit në terren dhe Projekt Raportit të Auditimit.

### Burimet njerëzore në TIK

Struktura e teknologjisë së informacionit në këtë institucion është në nivel Drejtorie. Për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Logjistikës dhe Dixhitalizimit është pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Zgjedhjeve dhe është e përbërë nga 3 (tre) sektorë me 11 (njëmbëdhjetë) nëpunës si më poshtë:

Fig.1: Struktura e Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit



**Tabela nr. 1: Struktura e Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit Plan/Fakt**

Nr.	Emërtimi	Numër v.2023	
		Plan	Fakt
<b>Drejtoria e Logjistikës dhe Dixhitalizimit</b>		11	9
1	Drejtor Drejtorie	1	1
<b>Spektori i Materialeve Zgjedhore</b>			
1	Shef Spektori	1	1
2	Specialist	2	2
<b>Spektori i Zhvillimeve Dixhitale</b>			
1	Shef Spektori	1	-
2	Specialist	3	2
<b>Spektori i Administrimit të të Dhënave Dixhitale</b>			
1	Shef Spektori	1	1
2	Specialist	2	2

*Burimi: KQZ, përpunuar nga grupi i auditimit*

## Trajnimet

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit.


Për periudhën objekt auditimi u konstatua se KQZ, për vitet 2022 dhe 2023, nuk ka plan trajnimi vjetor në lidhje me Teknologjinë e Informacionit për burimet njerëzore të Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit. Trajnimet e kryera nga stafi lidhen kryesisht me trajnimin bazë të ASPA për nëpunësin civil, si dhe trajnime të organizuara nga AKCESK mbi politikën e sigurisë kibernetike dhe ushtrime konkrete në lidhje me menaxhimin e incidentit dhe krizës kibernetike, për të cilat grupit të auditimit nuk i janë vendosur dokumentacion në dispozicion.

*Nga auditimi u konstatua se, KQZ nuk ka plan trajnimi vjetor në lidhje me Teknologjinë e Informacionit, për zhvillimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit. Nuk janë identifikuar dhe dokumentuar drejtime që kanë nevojë për trajnim.*

## Auditimi i Brendshëm

Struktura dhe organizimi i Sektorit të Auditit të Brendshëm në KQZ është miratuar me Vendim të Kuvendit nr. 67, datë 05.11.2020 si pjesë përbërëse e strukturës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë viteve 2022 dhe 2023, Spektori i Auditit të Brendshëm është organizuar me 1 Drejtor, 1 shef sektori dhe 2 specialistë. Spektori i Auditit të Brendshëm ka varësi organizative nga Sekretari i Përgjithshëm dhe varësi funksionale nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Me Vendimin nr.74, datë 22.09.2022 të Kuvendit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 67/2020 “për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë të plotë pune të komisionit qendror të zgjedhjeve” Spektori i Auditimit të Brendshëm ka kaluar në varësi të drejtpërdrejtë nga Titullari i institucionit dhe është në nivel sektori 1 shef sektori dhe 2 specialistë.

Fig. 2: Struktura e Sektorit të Auditit të Brendshëm në KQZ



Viti 2021, ka qenë viti i parë i punës së këtij Sektori, gjatë kësaj periudhe janë hartuar Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Plani i parë Strategjik dhe Vjetor 2022-2024.

Për vitin 2022, janë planifikuar 6 (gjashtë) angazhime auditimi dhe janë kryer të gjitha angazhimet e planifikuara.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në KQZ, për periudhën 01.01.2022-31.12.2024, nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, mbështetur në nenet 14 dhe 8 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik”. “Të kryejë auditime IT sipas përcaktimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm”.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik përcaktohet të kryhet në përputhje me:

- Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj;
- Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.
- Përcaktimet e nenit 4. Pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Nga auditimi mbi veprimtarinë e punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm, u konstatua se në drejtim të auditimit TI:

- Nuk kanë si pjesë të strukturës së tyre, Auditues IT;
- Nuk kanë kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit;
- Nuk ka zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-s;
- Nuk kanë akses në sistemet informatike për të aksesuar të dhëna që mund të ndihmojnë auditimin e brendshëm.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm në sektorin publik duhet të kryhet në përputhje me:

- Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe të gjitha aktet nënligjore bazuar në këtë ligj.
- Standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuara me urdhër të Ministrit të Financave;
- Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës për audituesit e brendshëm, manualin e auditimit të brendshëm, si dhe akte të tjera specifike për kryerjen e shërbimit të auditimit.
- Përcaktimet e nenit 4. Pika 6, nenit 9 dhe në përputhje me Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 27.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Ndryshimet në strukturën e KQZ të miratuar me vendimin Nr. 72/2022 të Kuvendit të Shqipërisë, janë miratuar në periudhë kohore më vonë nga data e miratimit të Planit Strategjik, si rrjedhojë nuk janë reflektuar ndryshimet përkatëse në lidhje me drejtorinë e IT. Ju sqarojme se do të bëhen përditësimet sipas rekomandimit tuaj në vazhdimësi.

\*\*\*

Pika 2. ... Drejtoria e Burimeve Njerezore në bashkëpunim me Drejtorinë e Logjistikës dhe Digjitalizimit ka marrë parasysh rekomandimin tuaj dhe ka reflektuar ndryshimet në përshkrimet e punës së punonjësve të DLD, në përputhje me Rregulloren e miratuar me Vendim të KSHZ nr. 21, datë 26.02.2024 dhe duke patur parasysh detyra të veçanta që mund të ketë secili prej punonjësve. Përshkrimet e punës janë përcjellë tek Titullari i AK (me urdhër) me shkresën nr. 1415 prot., datë 29.05.2024.

\*\*\*

Duke marrë në konsideratë shtimin e teknologjisë për proceset zgjedhore, si dhe volumin e madh të të dhënave personale që përpunohen nga KQZ, konstatimi juaj lidhur me marrjen e masave organizative për mbrojtjen e të dhënave personale do të adresohet nëpërmjet miratimit të politikave dhe procedurave standard të punës që janë në proces hartimi, si dhe caktimin me Urdhërin Nr. 58, datë 04.06.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve edhe të një nëpunësi tjetër të specializuar dhe me përvojë në fushën e teknologjisë së informacionit, me detyra të mirëpërcaktuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

\*\*\*

Në lidhje me auditimet e sistemeve IT nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, sqarojmë se ky rekomandim do të konsiderohet me përparësi, për këtë, gjatë hartimit të planit strategjik dhe vjetor të auditimit të radhës, atij 2025-2027 do të parashikohet që në një nga 3 vitet e këtij plani të mundësohet zbatimi i këtij rekomandimi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht përsëritëse, pasi janë trajtuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit.

Përsa i përket pikës 2, në lidhje me përditësimin e përshkrimeve të punës së punonjësve të Drejtorisë së Logjistikës dhe Digjitalizimit, observacioni juaj merret në konsideratë si dhe është trajtuar duke reflektuar ndryshimet në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, pjesa tjetër e konstatimeve të grupit të auditimit nuk ndryshojnë. Duke marrë në konsideratë shtimin e teknologjisë për proceset zgjedhore, si dhe volumin e madh të të dhënave personale që përpunohen nga KQZ, konstatimi juaj lidhur me marrjen e masave organizative për mbrojtjen e të dhënave personale do të adresohet nëpërmjet miratimit të politikave dhe procedurave standarde të punës që janë në proces hartimi, si dhe caktimin edhe të një nëpunësi tjetër të specializuar apo me përvojë në fushën e teknologjisë së informacionit, me detyra të mirëpërcaktuara sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

\*\*\*

Në zbatim të vendimin nr. 21 datë 26.02.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komisionet Qendror të Zgjedhjeve”, Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës dhe Digjitalizimit në bashkëpunim me Burimet njerëzore janë në fazën e përditësimit të formularëve të përshkrimeve të punës për çdo nëpunës. Gjithashtu duhet theksuar se në plotësim të gjetjes suaj njësia përgjegjëse do të ndjekë reflektimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave konkrete në formularët e përshkrimit të punës që lidhen veçanërisht me teknologjinë e informacionit.

\*\*\*

Bazuar në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12/03/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, dërgohet çdo vit nga burimet njerëzore planin vjetor të trajnimeve me tematikat sipas kërkesave të stafit drejt ASPA-s, i cili është institucioni publik qendror përgjegjës për ofrimin dhe organizimin e trajnimeve.

Përsa i përket programeve specifike të trajnimit në fushën e teknologjisë, institucioni ka vijuar komunikimin me ASPA-s, duke dërguar edhe tematika të tjera të krijuara gjatë proceseve të punës si:

- Siguria kibernetike
- Web Development
- Data Analysis
- Project Management

Gjithashtu për vitin 2024, njesia e Burimeve njerëzore për të pasur nëpunës më të kualifikuar veçanërisht në fushën e teknologjisë ka krijuar mundësinë duke parashikuar një fond të veçantë në buxhet për gjetjen dhe ofrimin e programeve të trajnimit në ASPA-s.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara janë përgjithësisht shpjeguese dhe përsëritëse, pasi janë diskutuar me grupin e auditimit gjatë fazës së terrenit. Përsa i përket planit vjetor të trajnimeve, grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion gjatë fazës së terrenit si dhe me observacionet përkatëse dokumentacion në lidhje me planin vjetor mbi propozimet përkatëse, për zhvillimin e trajnimeve specifike. Përsa më sipër konstatimet e grupit të auditimit nuk ndryshojnë.

## 2.2 Siguria e informacionit

Në zbatim të pikës 2.a. “*Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet*” dhe nën pikës 2.b. “*Siguria e të dhënave, ndërveprimi dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Verifikime onsite të dhomës së serverave të KQZ dhe infrastrukturës networku të institucionit;
- Skema e komunikimit të network-ut;
- Politikat mbi Sigurinë e Informacionit;
- Verifikimi i dokumenteve të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat;
- Konsultim me faqen e web-it të KQZ, etj.

### a. *Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet*

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (*versioni 1.0, datë 02.12.2008*) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Nisur nga fakti që infrastruktura e dhomës së serverëve është vendi ku sistemet informatike të qendëruara ruhen dhe ofrohen për shërbime të brendshme dhe të jashtme të institucionit, përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës, dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.


Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave të lokalizuar në katin e parë të KQZ-ës dhe aksesin në rrjet.

Gjatë vizitës onsite të zhvilluar nga grupi i auditimit në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në KQZ, u konstatuan disa problematikat e mëposhtme:

- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);

- Nuk përbëhet nga një dyshe me teknologjike e përlogaritur për pesha e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbajtje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;
- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- Nuk ka një rregullore/udhëzues të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera si: kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, qese, dosje, etj;
- Rrjeti i brendshëm për të gjithë godinën e KQZ-ës është e lokalizuar në një rack;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuara me qëllim evidentimin e problematikave të portave specifike ku mund të shfaqet një problem.

**Fig.3** Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën qendrore të KQZ-ës dhe asetëve të ndodhura në të



*Kabllimet e rrjetit për të gjithë godinën e KQZ-ës*



*Burimi: Grupi i Auditimit*

Gjithashtu, KQZ disponon një ambient të specifikuar si dhomë serverësh në ambientet e një magazine me vendndodhje në Lundër. Grupi i auditimit, i shoqëruar nga personat përgjegjës të drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit në KQZ, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverave në të cilën janë hostuar serverat e sistemeve: Sistemi Qendror i Identifikimit të Votuesve (SEIV), Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik (SAIB), Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votave dhe Rezultateve (SEMVR) si dhe pajisjeve të tjera.

Nga auditimi u konstatua se ambienti ku është lokalizuar infrastruktura fizike dhe ajo e sistemeve kryesore informatike, që KQZ disponon për procesin zgjedhor, nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë ISO 27001/2022.

*Fig.4 Pamjet e mëposhtme tregojnë gjendjen e dhomës së serverëve në godinën Lundër të KQZ-ës*




*Burimi: Grupi i Auditimit*

### Topologjia e Infrastrukturës network të KQZ

Infrastrukturat kryesore fizike në administrim të KQZ-së janë rrjeti LAN i brendshëm për nevoja të punës në zyrë të administratës si dhe infrastruktura TIK qendrore për hostimin e sistemeve dhe shërbimeve të KQZ që i shërbejnë teknologjisë në zgjedhje.

*Fig.5: Më poshtë paraqitet skema logjike e infrastrukturës fizike dhe topologjia e rrjetit të KQZ*




*Burimi: KQZ*

Në këtë infrastrukturë janë të lidhur kompjutera të cilët janë të konfiguruar me sistem operim Windows, printera multifunksional, printera zyre, WiFi i institucionit, si dhe pajisje NAS Synology.

Infrastruktura e përbërë nga servera fizik, firewall dhe switch-e, brenda të cilave janë ngritur disa makina të tjera virtuale që shërbejnë për modulet e reja të KQZ, paraqitet si në figurë.

**Fig.6:** Infrastruktura e përbërë nga servera fizik, firewall dhe switch-e, për modulet e reja



**Burimi:** KQZ

b. Siguria e të dhënave, ndërveprimi dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

### Politikat e sigurisë së informacionit

Auditimi i Vlerësimit të Politikave të Sigurisë së Informacionit në KQZ u krye me objektiv kryesor vlerësimin nëse në KQZ ekziston një drejtim strategjik i përshtatshëm dhe një mbështetje për sigurinë e informacionit në termat e politikave të sigurisë, mbulimin e saj, ndërgjegjshmëria në nivel institucional. Politikat e sigurisë së informacionit duhet të mbulojnë të gjithë risqet operationale dhe të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit.

Për këtë qëllim nga grupi i auditimit u kërkua informacion për:

- Akte ligjore që përcaktojnë kërkesat e sigurisë së informacionit;
- Politikat e shkruara dhe formale të sigurisë së informacionit, Plani i sigurisë së IT;
- Etj.

*Nga auditimi u konstatua se KQZ nuk disponon Politika/Procedura të Sigurisë së Informacionit me qëllim minimizimin e riskut të humbjes, tjetërsimit apo transferimit të informacionit konfidencial që akseson dhe administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij. Përgjatë periudhës objekt auditimi nuk është dokumentuar një raport mbi incidentet ndaj sigurisë.*

Mungesa e Politikave / Procedurave të Sigurisë së Informacionit, mbart riskun e humbjes, tjetërsimit apo transferimit të informacionit konfidencial.

### Active Directory

KQZ për menaxhimin e përdoruesve, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qendëruar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet, nuk përdor Active Directory. Çdo pajisje kompjuterike e drejtorisë qendrore në KQZ është e lidhur lokalisht, jo në një rrjet të qendëruar.



*Nga auditimi mbi ndërtimin* logjik të rrjetit të brendshëm dhe aksesimit të tij u konstatua se, në mungesë të konfigurimit me Domain Controller dhe aksesimit në rrjet nëpërmjet Active Directory, siguria në rrjetin e brendshëm është e rrezikuar për sa kohë nuk janë aplikuar për përdoruesit kufizime me impakt të drejtpërdrejtë në sigurinë e të dhënave dhe informacionit që administrojnë KQZ. Dokumentet, informacionet që krijohen dhe përpunohen nga çdo pozicion pune nevojitet të ruhet lokalisht, pasi konfigurimet aktuale nuk e bëjnë të mundur ruajtjen e tyre në server.

### **Procedura e backup-it**

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion të grupit të auditimit, rezultojnë procedurat për backup për faqen e internetit janë automatike në nivel makine në infrastrukturën e instaluar përmes VEEAM. Përveç këtyre, bëhen backup automatike të bazës së të dhënave ditore që janë në diskun lokal të makinës. Struktura e dokumenteve të sinkronizohet me frekuenca javore në makina rezervë që janë pasivë, për tu përdorur në rast incidenti.

Backup të tjerë të DB dhe dokumenteve ruhen dhe në storage të veçantë. Backup-et në VEEAM janë të enkriptuara. Për sistemet e implementuar së fundmi, ka procese të automatizuara backup-i në një zonë të izoluar. Ruajtja e të dhënave kryhet sipas modelit inkremental ditor/javor/mujor në nivel DB dhe dokumentacioni.

*Nga auditimi u konstatua se*, procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është pasqyruar apo dokumentuar në një dokument të brendshëm rregullues apo udhëzues, ku të jenë përcaktuar çfarë do të ruhet, si do të ruhet, periodiciteti dhe modeli i ruajtjes së tij. Procedura e backup-it aktuale, realizohet me iniciativë të punonjësve të IT, por kjo përgjegjësi për kontrollin dhe verifikimin e kryerjes së backup-ve nuk gjendet e adresuar tek asnjë pozicion pune.

Log-et menaxhohen nga administratorët e sistemeve përkatëse në nivel serveri, ku çdo log file ruhet në nivel aktiviteti si dhe në nivel databaze. Koha e ruajtjes së tyre është e ndryshme rast pas rasti.

*Nga auditimi mbi gjurmimin elektronik të problematikave u konstatua se*, KQZ nuk disponon ndonjë rregullore apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e logeve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, e për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, standardeve të sigurisë si dhe pikës 4 shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e logeve digjitale në Administratën Publike*”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT.

### **Vazhdimësia e ofrimit të shërbimit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat**

Me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash, nevojiten të hartohen plane të rikuperimit nga katastrofa (DRC), në të cilat dokumentohen masat dhe procedurat për rivendosjen në funksionim të sistemit me qëllim garantimin minimal të shërbimeve që ofrohen nëpërmjet sistemeve informatike, funksionet kritike, kohën e rikuperimit si dhe burimet njerëzore që përfshihen në rast emergjence.

*Nga auditimi u konstatua se*, në KQZ nuk janë:

- Analizuar dhe përcaktuar sistemet kritike, të dhënat kritike dhe konfidenciale të cilat i akseson në vazhdimësi apo përkohësisht sa herë është e nevojshme dhe në përputhje me aktivitetin e KQZ-ës.
- Ndërtuar plane të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit si dhe plan të rimëkëmbjes në rast të një ndërprerje nga arsye të ndryshme që mund të jenë natyrore, njerëzore apo fizike.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 27.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** .... Aktualisht jemi në fazën e hartimit të specifikimeve teknike të cilat do të jenë të bazuara në standardet e vendosura nga AKSHI për ndërtimin e dhomës së serverëve. ...

\*\*\*

Pika 3. Rekomandimi juaj pranohet dhe do të merret parasysh marrja e masave në vazhdimësi.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përsëritëse, pasi janë trajtuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit, dhe nisur nga angazhimi i subjektit për përmbushje e rekomandimeve, grupi i auditimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

### 2.3 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat input/output

Në zbatim të pikës 3 të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Përshkrim i përgjithshëm i sistemit të teknologjisë së informacionit në KQZ;
- Të dhënat e gjeneruara nga sistemi për shërbimet e ofruara;
- Aksesimi i sistemit me përdorues me të drejta “lexues”;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemet;
- Informacion mbi veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Manualet e përdorimit të sistemeve;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kryenin apo administrojnë shërbime të caktuara;
- Vizita në terren;
- Indikatorë dhe statistika, etj.

Në zbatim të Ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Pjesa III, Zgjedhësit dhe Përgatitja e Listës së Zgjedhësve, Kreu I, Përmbajtja, Hartimi dhe Miratimi i Listës së Zgjedhësve, neni 45/ pika 1, paracakton se zgjedhësi identifikohet në RKGjC nga përbërësit zgjedhorë.

Përbërës zgjedhorë quhen përbërësit e gjendjes civile si më poshtë:

- a) emri;
- b) atësia;
- c) amësia;
- ç) mbiemri;
- d) datëlindja;
- dh) numri personal i identifikimit;
- e) shtetësia;
- ë) kodi i vendbanimit;
- f) gjinia.

Bazuar në nenin 45/ pika 2, lista që përdoret nga KQV-ja në procesin e votimit përmban përbërësit e përcaktuar në shkronjat “a”, “ç”, “d”, “dh” dhe “f” të pikës 1, të këtij neni.

Në mbështetje të nenit 22 dhe 23 të Ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për efekt të identifikimit elektronik përgjatë zhvillimit të zgjedhjeve, KQZ-ës i duhet të disponojë listën e zgjedhësve në rang vendi.

*Kjo listë, gjenerohet nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, një bazë të dhënash shtetërore që administrohet nga DPGJC dhe që përmban përbërësit zgjedhorë të kërkuar në nenin 45/pika 1 përmendur më sipër.*

Për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021, KQZ i është drejtuar DPGJC me shkresën nr.567 prot. datë 25.01.2021, me qëllim identifikimin e të dhënave të çdo zgjedhësi nëpërmjet Pajisjeve Elektronike të Identifikimit – PEI, janë kërkuar të dhëna që disponohen sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor.

Për zgjedhjet e Organeve të Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023, KQZ i është drejtuar DPGJC me shkresën nr.1443 prot. datë 07.03.2023, me qëllim identifikimin e të dhënave të çdo zgjedhësi nëpërmjet Pajisjeve Elektronike të Identifikimit – PEI, janë kërkuar të dhëna që disponohen sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor.

Në të dy periudhat zgjedhore 2021 dhe 2023 KQZ, bazuar në Vendimin e Komisionit Rregullator, ka kërkuar të dhëna mbi foton e çdo zgjedhësi, si një informacion i depozituar në RKGJC gjatë pajisjes me dokumente identiteti biometrik, që janë Kartë Identiteti dhe Pasaportë.

Në udhëzimin e përbashkët nr.465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, janë përcaktuar institucionet dhe organet që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin.

KQZ ndodhet në listën e institucioneve që marrin të dhëna shkrese si dhe elektronike si më poshtë:

- Emër;
- Mbiemër;
- Numër personal;
- Atësi;
- Amësi;
- Datëlindje;
- Vendbanimi (adresa).

Nga auditimi konstatohet se në ndryshimet e udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, publikuar me nr. 189, datë 4.10.2022, të dhënat personale që KQZ merr nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile janë të njëjta.

Me dërgimin e Projekt Raportit të Auditimit, KQZ i ka përcjellë Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, konstatimin e KLSH-ës për të cilin janë marrë masa duke përditësuar Aneksin I të udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020.

Nga auditimi mbi elementët e zgjedhorë të shtuar në këtë Aneks u konstatua se, është shtuar dhe Foto e Votuesve, megjithëse ky element nuk është përbërës zgjedhorë sipas nenit nr.45 të Kodit Zgjedhor.

Në Vendimin e Komisionit Rregullator për *“Llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”*, citohet se:

- Shkronja f, pika 5 - *“Çdo PEI do të përmbajë listën e zgjedhësve të të gjitha QV-ve, me të dhënat e identifikimit të çdo zgjedhësi sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor, si dhe foton e çdo zgjedhësi të depozituar gjatë pajisjes me dokumente identiteti biometrik”*.

- Shkronja h, pika 5 – *“Të dhënat e identifikimit të kryer të çdo zgjedhësi do të përmbajnë regjistrin e votuesve (zgjedhësve që kanë votuar) do të përfshijnë çdo të dhënë sipas pikës “f” dhe do të ruhen në një hapësirë memorie të sigurt, të veçantë dhe të ndara nga të dhënat e tjera. Në momentin e identifikimit elektronik sipas ligjit, skedari i zgjedhësit të identifikuar pas nënshkrimit me gjurmën daktiloskopike të gishtit, ruhet në memorien e votuesve.”*

Për sa më sipër, gjurma daktiloskopike e gishtit shërben si nënshkrim biometrik, për të treguar pjesëmarrjen në votim, sikurse është përcaktuar në aktet rregullatorë për përdorimin e sistemit dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve.

Nga auditimi konstatohet se, KQZ si hartues i projekt akteve me karakter normativ, dhe Komisioni Rregullator si miratues i tyre, në vendimin e marrë për të kërkuar foton nga RKGjC, e cila nuk përcaktohet si përbërës zgjedhor në Kodin Zgjedhor, në nenin 45 të Kodit Zgjedhor, ku elementët përbërës zgjedhorë janë të dhënat si më poshtë:

- a) emri;
- b) atësia;
- c) amësia;
- ç) mbiemri;
- d) datëlindja;
- dh) numri personal i identifikimit;
- e) shtetësia;
- ë) kodi i vendbanimit;
- f) gjinia.

Bazuar në pikën pika 2 të këtij nenin, lista që përdoret nga KQV-ja në procesin e votimit përmban përbërësit e përcaktuar në shkronjat “a”, “ç”, “d”, “dh” dhe “f” të pikës 1, të këtij neni.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 27.06.2024 dhe nr. 1137/10, datë 28.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** KQZ i është drejtuar Komisionit Rregullator në lidhje me këtë konstatim dhe përgjigja e tyre është si vijon:

- Në përgjigje të konstatimeve nga KLSH, nga ana e tre anëtarëve të Komisionit Rregullator është theksuar fakti që aktet e Komisionit Rregullator nuk janë objekt i kontrollit/auditimit nga ana e KLSH, por vetëm e Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë. Edhe pas shqyrtimit të Projekt Raportit të Auditimit, vijojmë të mbajmë të njëjtin qëndrim lidhur me sa më sipër.

- Në faqen 27 të Projekt Raportit të Auditimit, grupi i auditimit thekson se:

“ Nga dokumentacioni i kufizuar i vendosur në dispozicion grupit të auditimit, nuk u arrit identifikohet nëse vendimi i Komisionit Rregullator është hartuar nga KQZ dhe administrata e saj apo nga vetë anëtarët e Komisionit Rregullator, por nisur nga fakti që KQZ ka përcjellë konstatimin e grupit të auditimit tek Rregullatori, në mënyrë të tërthortë grupi i auditimit bëhet me dije se ky vendim është hartuar dhe marrë nga ky komision”.

Vendimi nr. 2, datë 31.10.2020 “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje, në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i Komisionit Rregullator është propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve...

- Lidhur me masat e kërkuara për t’u marrë nga Komisioni Rregullator për ndryshime në nenin 45 të Kodit Zgjedhor sqarojmë që Kodi Zgjedhor është ligj dhe ndryshimi tij mund të realizohet vetëm me një ligj tjetër. Sipas nenit 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli të Ministrave, çdo deputet dhe 20 mijë zgjedhës. Në këto kushte Komisioni Rregullator si organ drejtues i KQZ dhe vetë KQZ si institucion, nuk kanë iniciativë ligjvënëse.

Komisioni Rregullator gjithashtu i është drejtuar institucionit tuaj me shkresën nr.219/5 prot., datë 29.04.2024 në lidhje me përgjigjen më të shtjelluar rreth konstatimeve nga ana Juaj, në Akt-konstatimin nr.3, protokolluar me tonën me nr. 219/4 prot., datë 22.04.2024. (shkresa bashkëlidhur materialit).

\*\*\*

KQZ i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme me shkresën nr. 1475 Prot., datë 04.06.2024, “Për njohje të disa gjetjeve të Raportit të Auditimit nga KLSH në KQZ”.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1475/1 prot., datë 24.06.2024, dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1475/2 prot., datë 24.06.2024, “Kthim përgjigje për njohje të disa gjetjeve të Raportit të Auditimit nga KLSH në KQZ”. Për sa më sipër sipas projekt udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, të ndryshuar, gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë reflektuar, sipas pikes 20 në Aneksin I, por është shtuar foto që nuk është përbërës zgjedhor duke tejkalluar përcaktimet e nenit 45, të Kodit Zgjedhor.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht shpjeguese dhe përsëritëse, pasi janë trajtuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit. Përsa i përket pikës 2, në lidhje me ndryshimet e udhëzimit nr. 189, datë 4.10.2022, observacioni juaj nuk merret në konsideratë madje është trajtuar duke reflektuar ndryshimet në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit, pasi ndryshimet në Aneks kanë tejkalluar përcaktimet ligjore. Grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim për të dy gjetjet e mësipërme.

### **KQZ ka ndërtuar një identifikim elektronik të vecantë dhe të bazuar në Kodin Zgjedhor.**

Forma e identifikimit elektronik në KQZ është e ndryshme nga identifikimi elektronik i përcaktuar në ligjin nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, përkatësisht në kreun II “Identifikimi elektronik i sigurt”:

- Neni 3, pika 7, ku citohet se ““Identifikim elektronik i sigurt” është procesi i identifikimit elektronik të një personi fizik dhe verifikimi i vërtetësisë së identitetit të tij, nëpërmjet përdorimit të të dhënave të identitetit personal në formë elektronike, të cilat përfaqësojnë në mënyrë unike personin fizik apo juridik, ose personin fizik që përfaqëson personin juridik”.

- Neni 6, pika 2 dhe 3, ku citohet se “Procedurat e identifikimit të sigurt plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

2. Garantojnë identitetin e mbajtësit të mjeteve të identifikimit.
3. Garantojnë përdorimin vetëm nga mbajtësi i mjeteve të identifikimit.”

Identifikimi Elektronik në Kodin Zgjedhor, neni 2/pika 27, është përcaktuar të jetë identifikimi i zgjedhësit nëpërmjet verifikimit të të dhënave personale nga leximi me pajisje dhe përqsja e tyre me bazën elektronike të të dhënave për listën e zgjedhësve të qendrës së votimit, si dhe regjistrimi në pajisje i shenjave daktiloskopike.

Gjurma e gishtit si një e dhënë shumë sensitive dhe foto, regjistrohen dhe administrohen në sistemin e dokumenteve biometrikë, aktualisht nën varësinë e Ministrisë së Brendshme.

Gjithashtu, bazuar në Kodin Zgjedhor, regjistrimi, ruajtja dhe analizimi mbi të dhënat e gjurmës së gishtit (shenjave daktiloskopike) dhe foto, janë ruajtur në bazën e të dhënave të sistemit të identifikimit elektronik, që KQZ administron gjatë periudhës zgjedhore.

Në të dy rastet, gjurma e gishtit e regjistruar nga pajisje të ndryshme në dy sisteme të ndryshme, shërben për të siguruar një identifikim elektronik.

Vlen të thuhet fakti që për një identifikim elektronik dhe të sigurtë në të gjitha institucionet që mund të lind nevoja, ato mund dhe duhet ti referohen të dhënave në sistemin elektronik të dokumenteve biometrikë, referuar ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ku në nenin 4/ pika 3 citohet se “Ndalohet krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të veçanta, për të njëjtin informacion ose qëllim”.

## Sistemi i identifikimit elektronik të Votuesve – SEIV

KQZ ka përdorur Sistemin e Identifikimit Elektronik të Votuesve – SEIV, për të gjithë zonat zgjedhore të vendit, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor dhe vendimeve të Komisionit Rregullator për zgjedhjet e viteve 2021 - 2023. Ky sistem u përdor për herë të parë për zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021, e më pas u aplikua edhe në zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022. Në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 14 Majit 2023, SEIV u implementua në 5,211 qendra votimi. Nëpërmjet këtij sistemi menaxhohen, konfigurohen dhe gjenerohen informacione për procesin e verifikimit të votuesve. Në këtë sistem importohen informacione nga Baza e të Dhënave të Votuesve të KQZ-ës, për të konfiguruar dhe krijuar grupin e të dhënave të nevojshme për çdo pajisje PEI. Në SEIV gjenerohen të dhëna që vijnë nga pajisjet PEI, raporte si dhe eksportohen të dhëna nga SAIB pas vlerësimit të rasteve të dyshimta.


Qëllimi i këtij sistemi është parandalimi i:

- Votimit të dyfishtë;
- Votimit familjar;
- Votimit për një zgjedhës tjetër.

Sistemi SEIV përbëhet nga komponentët si më poshtë:

- Pajisja Elektronike e Identifikimit, Identifikimi elektronik me nënshkrim biometrik është kryer nëpërmjet Pajisjeve Elektronike të Identifikimit - PEI.
- VIUClient - programi i specializuar për identifikimin e zgjedhësve i instaluar në pajisjen elektronike të identifikimit.
- Sistemi Qendror i Identifikimit të Votuesve, i cili bën të mundur përgatitjen dhe konfigurimin e PEI;
- Sistemi i Automatizuar i Identifikimit Biometrik (SAIB), i cili menaxhon procesimin e të dhënave biometrike, deduplikimin dhe detektimin e rasteve të dyshuara si votim i dyfishtë/shumëfishtë.

*Fig. 7: Komponentët e sistemit SEIV*



*Burimi: KQZ*

E gjithë veprimtaria operationale e sistemit qendror të identifikimit të votuesve (SEIV) konsiston në:

### 1. Sigurimin e të dhënave që i përkasin procesit parazgjedhorë, ku bën pjesë:

- Importimi i të dhënave të listave të votuesve të regjistruar;
- Hierarkia gjeografike;
- Informacion mbi zonën zgjedhore;


- Data dhe detajet e zgjedhjeve;
- Të dhënat e konfigurimit të qendrës së votimit.
- Konfigurimi i pajisjeve PEI ku vendosen skedarët e konfigurimit dhe bazës së të dhënave.
- Memoriet e jashtme USB të prodhuara nga SEIV që përmbajnë bazën e të dhënave të votuesve. Skedarët e konfigurimit pasi janë instaluar dhe konfiguruar në PEI, pajisja është gati për funksionimin dhe caktimin e qendrës së votimit në ditën e zgjedhjeve.

## 2. Procesi Zgjedhor

Në këtë proces bëhet hapja e zgjedhjeve për Verifikimin e Votuesve dhe i gjithë procesi i votimit me pajisjet PEI.

Pajisjeve Elektronike të Identifikimit – PEI, janë pajisje teknologjike të tipit end-to-end biometric, dizenuar për administrimin e të dhënave gjatë zgjedhjeve. Kjo pajisje përdoret për të identifikuar dhe verifikuar votuesit me kartë identiteti apo pasaportë, të dhënat e të cilave lexohen në ekran.

*Fig.8: Pamje mbi Pajisjen Elektronike të Identifikimit - PEI*



Pajisja PEI ofron mundësinë e skanimit të gjurmës së gishtit, që mund të përdoret si:

- Identifikim i votuesit, në rast se lexohen të dhënat biometrike;
- Skanim sipas skemës së përcaktuar nga KQZ dhe regjistrim i gjurmës së gishtit / gjurmë daktiloskopike si dëshmi e pjesëmarrjes së votuesit.

Procesi i verifikimit të votuesve kërkuar nga KQZ, vijon në mënyrë të përmbledhur sipas hapave më poshtë:

- Votuesi paraqitet në qendrën e votimit me një dokument të vlefshëm identiteti.
  - Punonjësi i qendrës së votimit, përdor PEI për të kërkuar informacionin e votuesit duke:
    - Skanuar kodin MRZ të kartës suaj të identitetit ose pasaportës, për të marrë numrin e identifikimit të votuesit;
    - Duke shënuar me dorë numrin e identifikimit të votuesit ose emrin, mbiemrin dhe datën e lindjes së tij. Kërkimi manual lejohet vetëm nëse dokumenti i identitetit është dëmtuar ose i padeshifrueshëm.
- Nëse votuesi gjendet dhe caktohet në qendrën aktuale të votimit, të gjitha informacionet për votuesin, duke përfshirë foton dhe të dhënat e tij personale, shfaqen në ekran. Ekрани do të bëhet i gjelbër, për të treguar suksesin në gjetjen e informacionit të votuesit në qendrën e votimit.
- Nëse një votues është regjistruar saktë në qendrën e votimit ku instalohet PEI, punonjësi i qendrës së votimit vërteton me sy dhe konfirmon që informacioni përputhet me votuesin e pranishëm në qendrën e votimit.
- Punonjësi i qendrës së votimit, i kërkon votuesit të paraqesë gishtin e caktuar në skanerin e gjurmëve të gishtave PEI.
- Gjurma e gishtit të caktuar nga votuesi, mblidhet si dëshmi e pjesëmarrjes së votuesit.
- Për të gjitha verifikimet e suksesshme, printohet një faturë votuesi, e cila përfshin informacione për votuesin, fotografinë, informacionin e qendrës së votimit dhe nëse gjurma e gishtit është skanuar apo jo, si dhe datën dhe orën e verifikimit.


Manuali i identifikimit të votuesve nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit gjendet i publikuar në web dhe përfshin të gjithë hapat e përcaktuar nga KQZ.

Identifikimi i rasteve të veçanta, për zgjedhësit të cilët nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve por u lejohet të identifikohehen dhe të votojnë në atë QV, janë:


- Vendim Gjykatë;
- Administrata Zgjedhore për ato zgjedhës që janë: Komisionerët e QV-së, operatori ose anëtarët e KZAZ-së.

Në rastet kur është e pamundur të merret shenja e gishtërinjve të zgjedhësit, ai duhet të nënshkruaj në listën fizike të zgjedhësve.

Operatori shtyp në ekranin e PEI-t “Nënshkroi” pasi zgjedhësi ka nënshkruar në listën fizike të zgjedhësve. Më pas printohet raporti në të cilin zgjedhësit i duhet të nënshkruajë me emër, mbiemër dhe firmë. Ky rast mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve nga Sekretari dhe nënshkruhet po aty nga Sekretari dhe Operatori.







Në rastin kur zgjedhësi ka pranuar të nënshkruajë dhe operatori ka zgjedhur opsionin “Nënshkroi”, shfaqet një tjetër mesazh “KQV të mbajë shënim rastin në librin e protokollit të mbledhjeve!”, me opsionet e zgjedhjes “Po” dhe “Jo” si në figurë.

*Nga auditimi u konstatua se*, kur është e pamundur të merret shenja e gishtërinjve të zgjedhësit, operatorit i shfaqet një mesazh gabimi, me opsionet “Nënshkroi” dhe “Nuk nënshkroi”. Në rastin kur zgjedhësi nuk pranon të nënshkruajë tek lista fizike e zgjedhësve, operatori klikon tek opsioni “Nuk nënshkroi” dhe në këtë rast atij nuk i jepet fleta e votimit. Në manual nuk jepen udhëzime në rast se Operatori ka zgjedhur gabimisht opsionin:

- “Nuk nënshkroi” megjithëse zgjedhësi ka nënshkruar në listën fizike të zgjedhësve;
- “Nënshkroi” megjithëse zgjedhësi nuk ka nënshkruar në listën fizike të zgjedhësve.

Nga auditimi mbi konfigurimin e përdorimit të pajisjeve elektronike të identifikimit - PEI u konstatua se, Operatori ka të drejtë të zgjedhë “Jo”, megjithëse mbahen shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve nga Sekretari dhe nënshkruhet po aty nga Sekretari dhe Operatori, për rastet që kanë pranuar të nënshkruajnë, në listën fizike të zgjedhësve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 27.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Për paragrafin e parë: Për rastet kur është e pamundur të lexohet shenja e gishtërinjve nga pajisja, mesazhi që shfaqet në ekran nuk është mesazh gabimi (error) por mesazh lajmërimi (alert) për t’i sjellë në vëmendje operatorit faktin se tentativat për leximin e shenjave të gishtit janë shteruar dhe duhet të vazhdojë me procedurën e nënshkrimit fizik nga ana e zgjedhësit. Në manual përshkruhet procedura që operatori DUHET të ndjekë, dhe implikimet se çfarë ndodh për çdo rast të mundshëm kryhen gjatë trajnimit nga trajnerët. Gjithsesi edhe në rast se operatori gabimisht zgjedh opsionin “Nuk nënshkroi”, procesi i identifikimit ndërpritet, duke mos u konsideruar si i identifikuar zgjedhësi dhe rrjedhimisht nuk mund të vijohet me hapat e tjerë proceduralë. Identifikimi mund të fillojë nga e para, që do të thotë se operatori ka mundësinë të zgjedhë opsionin e duhur “Nënshkroi”. Ndërsa në rastin e kundërt, KQV-ja ka detyrimin ta evidentojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Për paragrafin e dytë: Në lidhje me tabelën informuese, me zgjedhje “Nëse Komisioni i Qendrës së Votimit e ka mbajtur rastin shënim ose jo”, është detyrë shprehimisht e KQV-së ose më saktë e Sekretarit të mbajë shënimet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve, ndërsa Operatori vetëm kundërfirmos. Sqarojmë se Operatori nuk ka asnjë tagër për të mbajtur shënime në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Ky i fundit administrohet vetëm nga KQV-ja.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht shpjeguese si dhe janë trajtuar dhe diskutuar gjatë fazës së terrenit dhe në Projekt Raportin e Auditimit, ku një pjesë e tyre është reflektuar në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit. Konstatimi lidhet me nevojën për përmirësim që ka kjo problematik, për pasojë konstatimi i grupit të auditimit nuk ndryshon.

## **Mbyllja e procesit të identifikimit kryhet si më poshtë**

Pajisja është e konfiguruar që procesi zgjedhor të mbyllet në orën 19:00, para këtij orari mbyllja nuk mund të kryhet as si gabim njerëzor. Pajisja printon automatikisht raportin e mbylljes i cili bëhet pjesë e materialeve zgjedhore.

## **Procesi pas zgjedhor**

Në këtë proces pas mbylljes dhe gjenerimit të raporteve bëhet dhe grumbullimi dhe dedublikimi i të dhënave. Të gjitha PEI merren në Magazinën Qendrore të KQZ-ës dhe kryhen operacionet e mëposhtme:

- Të gjitha të dhënat përkatëse duke përfshirë të dhënat e ditës së zgjedhjeve dhe gjurmët e gishtave të kapur importohen nga memoriet e PEI në Backend-in SEIV;
- Raportet dhe statistikat;
- Dedublikimi, ku gjurmët e gishtave të skanuara importohen në komponentin SAIB dhe fillon dhe identifikohen rastet e dyshuara ku shenjat e gishtave janë të një përputhshmërie të mundshme. Kjo gjë realizohet nga zyrtarët e Vlerësimit të KQZ-ës.

KQZ verifikon nëse rezultojnë votues të shumëfishtë dhe përgatit materialin kallëzues për prokurorinë rast pas rasti të konstatuar nga analizimi mbi bazën e të dhënave të gjurmës së gishtave, që janë mbledhur nga pajisjet e identifikimit elektronik, në zbatim të nenit 167/2, pika 4, të ligjit nr.101/2020, datë 23.07.2020 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga auditimi mbi konfigurimet aktuale për identifikimin nëpërmjet pajisjeve PEI, u konstatua se zgjidhja e implementuar në zgjedhjet e periudhës 2021-2023, ku regjistrimi i gjurmës së gishtit është përdorur si nënshkrim biometrik, nuk ka mundur të parandalojë rastet si më poshtë:

- Votimin e dyfishtë, ku ka pasur raste në qendra votimi të ndryshme, të identifikohen votues me ID të njëjta, nga votues të identifikuar si administratë zgjedhore ose votues me Vendim Gjykate, për të cilat janë identifikuar 43 raste;
- Votimin familjar ose votimin për një zgjedhës tjetër, ku ka pasur raste të kenë nënshkrim të njëjtë votues të identifikuar me ID të ndryshme, për të cilat ka patur 213 me përputhshmëri të mundshme në zgjedhjet e vitit 2023.

Për identifikimin elektronik të zgjedhësve, nuk janë përdorur të dhënat që gjenden në dokumentet e identifikimit elektronik që janë Karta dhe Pasaporta, të pajisura me të dhëna biometrike që krijohen, ruhen dhe ofrohen nga institucioni përgjegjës për prodhimin e dokumentave biometrikë. Për identifikim elektronik KQZ ruan gjurmën e gishtit që regjistrohet në ditën e votimit, për kontroll paszgjedhor me qëllim identifikimin elektronik “*a posteriori*”. KQZ për 256 rastet e mësipërme, në zbatim të pikës 4, nenit 167/2 e Kodit Zgjedhor, ishte duke përgatitur materialin kallëzues për prokurorinë.

Konstatimi është bazuar në kriterin që përcaktohet me nenin 2/pika 27 si dhe pika 4, neni 167/2 në Kodin Zgjedhor, pika 4 e nenit 167/2 e Kodit Zgjedhor, Konfigurimet e sistemit.

Sipas të dhënave të KQZ-ës, për 75,132 votues ose 5% e numrit total të votuesve në të gjithë vendin, për zgjedhjet e vitit 2023, nuk është regjistruar gjurmë gishti dhe identifikimi i zgjedhësve është bërë me kërkim manual në të dhënat që gjenden në pajisjet PEI. Në këto raste dokumenti i identifikimit nuk është lexuar nga pajisjet e identifikimit elektronik PEI, nëpërmjet MRZ – Machine Readable Zone.

Në përfundim të zgjedhjeve 2023, KQZ ka ngritur një grup pune me urdhrin nr.78, datë 16.05.2023 “Verifikimin e shkaqeve të mosfunksionimit të pajisjeve elektronike të identifikimit të zgjedhësve – PEI në disa qendra votimi në zgjedhjet e datës 14 maj 2023”. Grupi ka kryer verifikimet e nevojshme dhe ka hartuar raportin përmbledhës arkivuar me shkresën nr.7716 prot., datë 23.11.2023 ku ka identifikuar disa problematika, ku çështjet e lidhura me pajisjet dhe sistemin janë:

- Log-et e pajisjeve PEI në nivel sistemi operimi janë fshirë pas çdo restart-imi të pajisjeve.
- Pajisjet nuk janë lidhur me rrjetin GSM për të bërë të mundur transmetimin e pjesëmarrjes, si pasojë e mungesës së valëve ose sinjalit të dobët në QV;
- USB nuk lexohet dhe pajisja nuk mund të operojë për të kryer identifikimin e zgjedhësve;
- Pajisje të cilat ditën e votimit kanë rezultuar me statusin “Transmetuar”;
- Versioni software është instaluar gabim për shkak se nuk është kryer saktë instalimi i versionit të ri të aplikacionit të zgjedhjeve dhe nuk është arritur të identifikohet kjo problematikë gjatë verifikimit të pajisjeve në përfundim të procesit të përgatitjes së pajisjeve.

Situata mbi mospërdorimin e pajisjeve elektronike të identifikimit për zgjedhjet e fundit të 14 Majit 2023, ka rezultuar se nga 581 pajisje prej të cilave nuk ka pasur transmetim gjatë ditës së zgjedhjeve, janë klasifikuar si:

- 68 raste ose 12% e rasteve qendra votimi të cilët nuk ka pasur operator dhe nuk janë përdorur pajisjet PEI;
- 311 raste ose 53% e rasteve kur pajisjet PEI kanë funksionuar gjatë zgjedhjeve, por nuk ka transmetuar të dhëna;
- 202 raste ose 35% e rasteve kur PEI nuk ka funksionuar.

Grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.78, ka rekomanduar që në lidhje me këtë çështje të ulet numri i kërkimit automatik për ndërlidhje të pajisjeve PEI në rrjetin GSM në një numër të arsyeshëm tentativash për të mos ngarkuar këto pajisje gjatë procesit të identifikimit.

Komisioni Rregullator me vendimin nr.7, datë 20.02.2023, ka përcaktuar të dhënat që transmetohen gjatë ditës së zgjedhjeve nga pajisja elektronike e identifikimit (PEI) drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) të KQZ, ndërmjet të tjerave përfshihen:

- Numrin e votuesve të identifikuar me shenja gishtërinjsh;
- Numrin e votuesve të identifikuar pa shenja gishtërinjsh;

Në pikën 6 të këtij vendimi thuhet se Transmetimi i të dhënave ndodh me frekuencë periodike.

Në pajisjet e identifikimit elektronik PEI, janë bërë konfigurime për transmetim çdo një orë, megjithëse ky periodicitet specifik nuk është përcaktuar në vendimin e Komisionit Rregullator.

Gjithashtu, KQZ si hartues dhe Komisioni Rregullator si miratues kanë specifikuar transmetim të të dhënave për “Numrin e votuesve të identifikuar me shenja gishtërinjsh” dhe “Numrin e votuesve të identifikuar pa shenja gishtërinjsh”, ku shenja e gishtërinjve nuk shërben në asnjë rast si identifikim, por si nënshkrim biometrik për pjesëmarrjen në votim.

### **Sistemi i Votimit dhe Numërimit Elektronik**

Sistemi i Votimit dhe Numërimit Elektronik përbëhet nga:

- Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votave dhe Rezultateve - SEMVR;
- Pajisjet e Votimit dhe Numërimit Elektronik - PEVN.

Ky sistem ka filluar pilotimin e tij fillimisht në Njësinë Administrative nr. 10 në Tiranë dhe në zgjedhjet e 14 Majit 2023 u shtri në të gjithë qarkun e Elbasanit, Kamëz dhe Vorë.

Pajisjet e Votimit dhe Numërimit Elektronik – PEVN, mundësojnë votimin elektronik dhe llogaritjen e rezultatit përfundimtar në SEMVR, në nivel të çdo qendre votimi pas mbylljes së procesit të votimit.

Pajisjet PEVN shoqërohen nga një kuti e pajisur me printer që mundëson printimin fizik të votës dhe ruajtjen elektronike të saj dhe dy memorie USB të veçanta ku ruhen elektronikisht votat dhe funksionojnë si backup i njëra tjetrës.

Operatori Teknik i ngarkuar për përdorimin e PEVN nëpërmjet kartave smart dhe kodeve përkatëse bën hapjen e PEVN-ve duke printuar dhe dorëzuar KQV-së raportin e hapjes së votimit i cili përmban të dhëna mbi: orën e hapjes, numrin e QV-ës dhe të pajisjes si dhe

treguesin e sigurisë që duhet të jetë me zero pjesëmarrës në votim. Ky raport printohet në 8 kopje dhe firmoset nga anëtarët e KQV-së.

Pajisja PEVN gjithashtu shoqërohet dhe me një buton të tipit Pulsant, nga një për secilën pajisje, dhe këtë pulsant e komandon një nga anëtarët e KQV-ës. Anëtari i QV nëpërmjet butonit të tipit pulsant aktivizon PEVN-në për votim në kohën kur votuesi pasi ka kryer me sukses procesin e identifikimit në PEI shkon fizikisht tek PEVN për të votuar.

Gjatë kohës kur nuk kryhet procesi i votimit në PEVN pulsanti ka ngjyrë të gjelbër, sa fillon procesi i votimit ngjyra bëhet portokalli dhe qëndron i tillë gjatë gjithë procesit të votimit të një votuesi. Anëtari i QV e aktivizon procesin e votimit elektronik për votuesin e radhës vetëm kur butoni ka kaluar në ngjyrë të gjelbër.

Në raportet përfundimtare që gjenerohen nga pajisjet e identifikimit elektronik - PEI dhe pajisjet e votimit elektronik - PEVN, vetë punonjësit u shprehën se ka patur raste kur numri i zgjedhësve të identifikuar është i ndryshëm nga numri i votave elektronike. Ky kontroll, bazuar në konfigurimet aktuale të pajisjeve dhe sistemeve respektive nuk mund të bëhet në kohë reale, por vetëm në mbyllje të votimit, pasi pajisjet nuk janë të lidhura me njëra tjetrën.

Aktivizimi i procesit të votimit në pajisjet PEVN kryhet manualisht nëpërmjet një pajisje fizike të quajtur “pulsant” i cili i caktohet një nga anëtarëve të QV-s për ta aktivizuar sa herë që një votues është gati për votim. Ky proces duke qenë manual mund të ndodhë të aktivizohet më shumë se një herë për të njëjtin votues.

Pajisjet PEI dhe PEVN funksionojnë të pavarura dhe jo me ndërveprim me njëra tjetrën, çfarë nuk mundëson aktivizimin e sesionit për votim automatikisht në pajisjet PEVN, për çdo herë që është përfunduar një identifikim nëpërmjet pajisjeve të identifikimit PEI.

Pasi anëtari aktivizon sesionin e votimit për votuesin atij i shfaqet në ekran fleta e votimit e cila përmban emrat e kandidatëve sipas konfigurimit të bërë për procesin zgjedhor. Në fund të procesit votuesi pasi ka verifikuar dhe konfirmuar zgjedhjen e tij, i jepet mundësia të printojë votën, si dhe pajisja shfaq mesazh konfirmimi për votimin me sukses dhe kryen mbylljen e ndërfaqes së votimit.

Kur arrihet fundi i ditës së zgjedhjeve, PEVN i nënshtrohet procesit të Mbylljes së Votimit. Votimet mbyllen, vetëm nëse data dhe ora e konfiguruar në PEVN korrespondojnë me datën dhe orën e zgjedhjeve. Operatori logohet sërish në pajisje dhe shtyp opsionin: Mbyll procesin e votimit. Sistemi do të fillojë të kryejë procesin e Mbylljes së Votimeve në të cilin Raporti i Mbylljes së Zgjedhjeve me kodin QR do të printohet automatikisht dhe do të hidhet në kutinë e votimit. Përpara se të fillojë procesi i printimit, sistemi i kërkon operatorit të vendosë printerin në Modalitetin e Raportimit dhe printohen 8 kopje të Raportit Të Mbylljes së Votimit dhe 8 kopje të Raportit të Përmbledhjes me kod QR.

*Procesi i transmetimit të Rezultateve.* Pasi sistemi kërkon konfirmimin për të filluar transmetimin e rezultateve, operatori vendos modemin USB.

Vetëm mbasi është mbyllur procesi në PEVN dhe janë printuar raportet e rezultateve, operatori teknik i ngarkuar nga KQZ vendos në një nga portat e PEVN modemin USB, i cili mundëson transmetimin e rezultateve paraprake të PEVN në sistemin SEMVR. Të dhëna nuk transmetohen në kohë reale. Sistemi verifikon aksesin në rrjet dhe i dërgon rezultatet në vendndodhjen e centralizuar. Pasi rezultatet janë transmetuar, printohet një raport i statusit të transmetimit si dëshmi e transmetimit. Në rast të pamundësisë teknike për të transmetuar të dhënat në sistemin SEMVR, informacioni merret nga USB-të e vendosura në pajisje.

I gjithë informacioni i ruajtur në pajisje është i koduar me një algoritëm simetrik inkriptimi, duke përfshirë rezultatet e konsolidimit dhe paketat e të dhënave që do të transmetohen. Pajisja funksionon në mënyrë autonome pa u lidhur me rrjetet e komunikimit elektronik. Pas mbylljes së procesit zgjedhor votat numërohen automatikisht dhe nga çdo pajisje printohet rezultati. Çdo

pajisje i ruan rezultatet në median e vet, të cilat në fund të votimit regjistrohen dhe grumbullohen në sistemin SEMVR.

Në të gjitha rastet pilot të votimit elektronik duke përdorur pajisjet PEVN, nuk ka ndodhur që të kenë humbur të dhënat elektronike që nuk janë transmetuar.

Nëse transmetimi i të dhënave nuk ka përfunduar me sukses për ndonjë arsye teknike dhe USB që mbajnë informacionin elektronik janë dëmtuar i gjithë materiali elektronik i ruajtur humbet, por votat janë të printuara gjatë procesit të votimit elektronik.

Në dispozicion të grupit të auditimit u vendos një analizë e kryer nga Drejtoria e Logjistikës dhe Dixhitalizimit për Votimin Elektronik, të implementuar në bashkitë: Elbasan, Kamëz dhe Vorë. Pajisjet PEVN në dispozicion kanë qenë 802 pajisje, 26 prej të cilave rezervë, për çdo rast që mund të ishte e nevojshme. Në këtë raport janë dokumentuar gjithsej 5 çështje të konsideruara si konkluzione të pilotimit të pajisjeve PEVN, ku konsistojnë në përgatitjen dhe kontaktimin e teknikëve, shpërndarjen e pajisjeve si dhe fushata gjithëpërfshirëse për familjarizimin me votimin elektronik.

Nga auditimi mbi përfundimin e fazës së pilotimit për votimin elektronik, KQZ nuk ka kryer një vlerësim mbi përfitimet, mangësitë, vështirësitë si dhe nevojat për përmirësim të kësaj infrastrukture, me qëllim marrjen e sigurisë së arsyeshme se sistemet dhe pajisjet e teknologjisë të përdorura për votim elektronik pilot, i nënshtrohen parimeve që cilësohen dhe në nenin 22 “Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje”, të Kodit Zgjedhor mbi sigurinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 28.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** Në përfundim të çdo procesi pune për implementimin e votimit elektronik, KQZ bazuar në verifikimet që ka bërë gjatë procesit zgjedhor, në raportet e gjeneruara nga kompania me të cilën ka marrëveshje për PEVN dhe në rezultatin e hapjes së kutive të votimit harton një raport final për ecurinë e procesit.

Aktualisht KQZ ka të ngritur Grupin e Punës me Urdhrin nr. 27, datë 05.03.2024 dhe është në proces të hapjes së kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore për vlerësimin përfundimtar të ecurisë së procesit të votimit elektronik.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nisur nga fakti se KQZ është në proces për vlerësimin e ecurisë së fazës së pilotimit për votimin elektronik, grupi i auditimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit me qëllim dokumentimin e plotë të gjithë këtij procesi.

Në përfundim të çdo procesi pune për implementimin e votimit elektronik, KQZ bazuar në verifikimet që ka bërë gjatë procesit zgjedhor, në raportet e gjeneruara nga kompania me të cilën ka marrëveshje për PEVN dhe në rezultatin e hapjes së kutive të votimit harton një raport final për ecurinë e procesit.

Aktualisht KQZ ka të ngritur Grupin e Punës me Urdhrin nr. 27 datë 05.03.2024 dhe është në proces të hapjes së kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore për vlerësimin përfundimtar të ecurisë së procesit të votimit elektronik.

### **Platforma Elektronike e Raportimit Financiar - PERF**

Kjo platformë përmban disa faza që i përkasin raportimit financiar të partive politike në KQZ. Raportimi fillon që nga momenti i vetë deklarimit të pasqyrave financiare nga partitë politike si për vit jo zgjedhor, ashtu edhe për fushata zgjedhore, monitorimi i tyre gjatë procesit zgjedhor, përfshirja e KQZ-së përgjatë procesit të auditimit (komunikimet auditues - financiar partie) dhe në fund vendimmarrja. Portali i deklarimit online mundëson procesin e plotësimit të raporteve financiare, raporteve të monitoruesve gjatë fushatës zgjedhore dhe raporteve të

auditimit nëpërmjet zhvillimit të dokumenteve të sigurta elektronike. Platforma aksesohet nëpërmjet një linku që gjendet në faqen zyrtare të KQZ-ës. Përdoruesit e platformës janë të ndarë sipas roleve: Financier, Miratues (firma e dytë), Miratues KQZ, Monitorues, Kandidat i pavarur dhe Admin.

**Tabela nr.2: Llojet e attributeve për secilin rol në sistem**

Roli	Përshkrimi
Admin	Krijim përdoruesi, fshirje përdoruesi, krijim event
Auditues	-
Financier	Krijim raporti, fshirje raporti (para dërgimit), editim raporti, dërgim raporti, krijim i miratuesit të raportit (firma e dytë)
Miratues Raportesh	Miratton Raportin Financiar, refuzon raportin financiar
Miratues KQZ	Miratton raportin financiar, refuzon raportin financiar, miratton raportin e monitorimit, refuzon raportin e monitorimit
Kandidat	Krijon raport financiar, editon raportin financiar(para dërgimit), dërgon raportin financiar
Monitorues	Krijon raport monitorimi, editon raportin (para dërgimit), dërgon raportin

**Burimi:** Të dhëna nga KQZ

Në këtë sistem ka gjithsej 208 përdorues të ndarë sipas sasisë dhe roleve: 49 Financier, 31 Miratues (firma e dytë), 2 Admin, 2 Miratues KQZ, 122 Monitorues dhe 2 Kandidat të pavarur. Në menunë kryesore, përdoruesit i paraqiten raportet e monitorimit në mënyrë grafike. Në raport pasqyrohet statusi i raportit: “Draft”, “Në pritje”, “Miratuar”, “Refuzuar”. Hostimi i kësaj platforme realizohet në serverët e OE që e ka ndërtuar si modul.

Nga auditimi u konstatua se në këtë sistem:

- Nuk lejohet shkarkimi i raporteve nga përdorues të KQZ-s, që kanë të drejta miratimi përpara se ata ti miratojnë ato;
  - Nuk mundësohet gjenerimi i raporteve në format Excel apo formatet të tjera të përdorshme dhe të nevojshme me qëllim realizimin e statistikave të ndryshme;
  - Nuk është bërë ende konfigurimi i rolit auditues në sistem;
  - Drejtoria e IT-së në KQZ nuk ka njohuri të dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi dhe nuk është parashikuar marrëveshje e nivelit të shërbimit duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe vazhdimësinë e punës në këtë sistem.
- Konstatimi është bazuar në Kodin Zgjedhor, Platforma e raportimit financiar të partive politike në KQZ.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 28.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** .... kërkesa tonat, konkretisht të parashikuara në zërin ‘Shërbime të teknologjisë së informacionit’, si kërkesë buxhetore të menjëhershme për vitin 2024, përpos angazhimeve të marra me donatorët, gjejnë mbështetje edhe në Vendimin nr. 710, datë 21.8.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit” (ndryshuar me VKM nr.755, datë 26.10.2016; nr. 287, datë 19.5.2021) ...

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Argumentet e parashtruara nga subjekti i audituar janë përgjithësisht përsëritëse, pasi janë trajtuar në fazën e Projekt Raportit të Auditimit. Për sa më sipër, grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim me qëllim që të ndihmojë instiucionin të adresojë me prioritet masat në rastin e parë që do të jetë e mundur.

**Modulet e modernizimit të KQZ**

KQZ ka implementuar një infrastrukturë hiperkonvergjente, e cila është e përbërë nga disa makina fizike, brenda të cilave janë ngritur disa makina të tjera virtuale, që shërbejnë për modulet e reja që KQZ është duke ngritur me qëllim informatizimin e proceseve të punës.

Pjesë e këtyre moduleve të KQZ janë:

- *Aplikacioni mobile i KQZ* - ka përdorues të ndarë në role: operator PEI, anëtar/ sekretar/ kryetar KZAZ, anëtar/ sekretar/ kryetar KQV;
- *Moduli i Vëzhguesve* - ka përdorues të ndarë në këto role: organizata/media, miratuesi KQZ, Komisioneri (aprovues), administrator.
- *Moduli i subjekteve zgjedhore* - ka përdorues që janë njëkohësisht përdorues të aplikacionit mobile;
- *EDMS* - është në proces implementimi dhe ka përdorues të gjithë administratën e KQZ;

Nga auditimi mbi modulet e modernizimit u konstatua se:

- Modulet janë ende në proces dixhitalizimi, hedhje të të dhënave si dhe në fazë pilotimi dhe ende nuk janë hartuar manuale përdorimi ose rregullore në lidhje me funksionimin e secilit modul. Informacion që gjendet aktualisht i takon zgjedhjeve të fundit të zhvilluara në vitin 2023, ndërsa popullimi i të dhënave historike ende nuk ka filluar;
- Drejtoria e IT-së në KQZ nuk ka njohuritë dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi dhe nuk është parashikuar marrëveshje e nivelit të shërbimit duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe vazhdimësinë e punës në këtë sistem

Nga auditimi mbi sistemet që disponon KQZ, u konstatuan disa mangësi të njëjta që janë:

- Detyrat e administratorëve, të drejtat e tyre si dhe detyrimet nuk janë adresuar tek punonjës specifik të IT-s. Këto role janë caktuar në bazë të ndarjes së punëve brenda strukturës të TI;
- Nuk janë hartuar, miratuar apo zbatuar politika të caktuara mbi krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve të sistemit;
- Nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si gjatësia, përmbajtja, përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas praktikave më të mira, standardeve si dhe pikës 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “*Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike*” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1137/9, datë 28.06.2024 “Mbi Projekt Raportin e Auditimit”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i subjektit:** KQZ është në proces të hartimit të politikave të sigurisë dhe procedurave standarde për të gjitha proceset e punës që lidhen me përdorimin e teknologjisë si nga stafi, ashtu edhe nga administratorët e sistemeve IT.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nisur nga angazhimi i subjektit për përmbushjen e rekomandimit, grupi i auditimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim në këtë Raport Përfundimtar të Auditimit.

## IV. REKOMANDIME

### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si hartues i projekt aktit me karakter normativ nr.02, datë 31.10.2020 dhe Komisioni Rregullator si miratues i tij, ka marrë vendimin për të kërkuar foton nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, një element që nuk përcaktohet si përbërës zgjedhor në Kodin Zgjedhor. Bazuar në nenin 45 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, përbërës zgjedhorë janë të dhënat si më poshtë: a) emri; b) atësia; c) amësia; ç) mbiemri; d) datëlindja; dh) numri personal i identifikimit; e) shtetësia; ë) kodi i vendbanimit; f) gjinia.

Në të dy periudhat zgjedhore 2021 dhe 2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në Vendimin e Komisionit Rregullator, ka kërkuar të dhëna mbi foton e çdo zgjedhësi, si një informacion i depozituar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, megjithëse kjo e dhënë nuk është përcaktuar si përbërës zgjedhorë në Kodin Zgjedhor.

Në udhëzimin e përbashkët nr.465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, janë përcaktuar institucionet dhe organet që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin.

Nga auditimi konstatohet se në ndryshimet e udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020, ndërmjet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe Ministrisë së Brendshme, publikuar me nr. 189, datë 4.10.2022, të dhënat personale që KQZ ka marrë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, kishin mbetur të njëjta.

Me dërgimin e Projekt Raportit të Auditimit nga KLSH, KQZ i ka përcjellë Ministrisë së Brendshme dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale, konstatimin e KLSH-së për të cilin janë marrë masa duke përditësuar Aneksin I të udhëzimit nr.465, datë 10.12.2020.

Nga auditimi mbi elementët e zgjedhorë të shtuar në këtë Aneks u konstatua se, jo vetëm nuk është ruajtur emërtimi sipas nenit 45 të Kodit Zgjedhor, por është shtuar dhe Foto e Votuesve, megjithëse ky element nuk është përbërës zgjedhorë sipas këtij neni.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Rregullator të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për shtimin e fotos si përbërës zgjedhor në nenin 45 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, për sa kohë ky element vlerësohet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për identifikimin e votuesve.

*Menjëherë*

### B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentin strategjik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, konstatohet se plani strategjik nuk është përditësuar ku të jenë reflektuar ndryshimet që ka pësuar struktura e KQZ me vendimin nr. 74/2022, të Kuvendit të Shqipërisë. Gjithashtu, nisur me zhvillimet teknologjike që KQZ ka implementuar së fundmi konstatohet se, nuk ka një plan strategjik për Teknologjinë e Informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-13 të Projekt Raporti të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për hartimin e një plani strategjik që përfshin elementë të Teknologjisë së Informacionit, politikat e sigurisë, planifikimin dhe zhvillimin e aplikacioneve, infrastrukturën dhe strukturën aktuale të IT-së, ndryshimet që ka pësuar struktura e KQZ si dhe elementë të tjerë përbërës të cilët ndihmojnë të arrihen objektivat e institucionit.

*Brenda vitit 2024*



**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka plan trajnimi vjetor në lidhje me Teknologjinë e Informacionit, për zhvillimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Logjistikës dhe Dixhitalizimit. Nuk janë identifikuar dhe dokumentuar drejtime që kanë nevojë për trajnim.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime profesionale në teknologjinë e informacionit bazuar në zonat ku mungojnë kompetencat e caktuara tek punonjësit e strukturës së Logjistikës dhe Dixhitalizimit si dhe të zhvillojë trajnime bazuar në prioritetet e zhvillimit të teknologjisë që disponon dhe planifikon të kryejë institucioni.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi strukturën e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, u konstatua se nuk ka në strukturën e saj një pozicion dhe detyra të përcaktuara për Sigurinë e të Dhënave, në kushtet kur institucioni mbledh, ruan dhe përpunon të dhëna personale dhe sensitive. Masat organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesimin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, rrjedh si detyrim i nenit 27/pika 1 në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012, ndryshuar me ligjin nr.120/2014, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të marrë masa për përcaktimin e detyrave specifike në lidhje me Sigurinë e të Dhënave që mbledh, ruan dhe përpunon, me qëllim dokumentimin e masave tekniko-organizative për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera në fuqi.

*Brenda vitit 2024*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e zhvillimeve të auditimit të teknologjisë së informacionit nga Auditimi i Brendshëm, u konstatua se:

- Nuk kanë si pjesë të strukturës së tyre, Auditues IT;
- Nuk kanë kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit;
- Nuk ka zhvilluar burimet njerëzore me njohuri për auditimin e TI-s;
- Nuk kanë akses në sistemet informatike për të aksesuar të dhëna që mund të ndihmojnë auditimin e brendshëm.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet 7-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të konsiderojë me prioritet auditimin e vazhdueshëm të teknologjisë së informacionit si pjesë e Auditit të Brendshëm, duke përfshirë auditues me profil në Teknologjinë e Informacionit, duke i ofruar institucionit një siguri të arsyeshme në zhvillimet e pashmangshme të teknologjisë së informacionit në tërësi dhe të sistemeve informatike në veçanti.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi kushtet teknike në dhomën e serverave dhe infrastrukturës network në KQZ, u konstatuan problematikat e mëposhtme:

- Muret e dhomës së serverëve nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- Nuk përbëhet nga një dysheme teknologjike e përllogaritur për peshë e rackeve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen si dhe pënde në drejtim të derës së dhomës së serverëve në rast përmbajtje;
- Nuk përmbush kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;

- Nuk përmbush kushtet teknike lidhur me kapacitetin, cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- Nuk ka një rregullore/udhëzues të miratuar për personat e autorizuar që mund të hyjnë në dhomën e serverëve;
- Në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen materiale të tjera si: kuti, pajisje jashtë funksionimit, kabuj, qese, dosje, etj;
- Rrjeti i brendshëm për të gjithë godinën e KQZ-ës është e lokalizuar në një rack;
- Kabllimet dhe lidhjet e rrjetit në switch dhe patch panel nuk janë të sistemuara me qëllim evidentimin e problematikave të portave specifike ku mund të shfaqet një problem.

Gjithashtu u konstatua se ambienti ku është lokalizuar infrastruktura fizike dhe ajo e sistemeve kryesore informatike, që KQZ disponon për procesin zgjedhor, nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare të sigurisë ISO 27001/2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nevojitet të marrë masa për përmirësimin e kushteve të dhomës së serverave, përse është konstatuar nga grupi i auditimit, për të ndërtuar një infrastrukturë qendrore të teknologjisë së informacionit në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se KQZ nuk disponon Politika / Procedura të Sigurisë së Informacionit që të përcaktojnë veprimet dhe udhëzimet për minimizimin e riskut të humbjes, tjetërsimit apo transferimit të informacionit kofidencial që administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Politikave / Procedurave të Sigurisë së Informacionit, me qëllim njohjen dhe minimizimin e riskut të incidenteve që mund të sjellin humbje, tjetërsim apo transferim të informacionit kofidenciale që akseson dhe administron institucioni në përputhje me aktivitetin e tij.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi ndërtimin logjik të rrjetit të brendshëm u konstatua se KQZ nuk disponon një infrastrukturë të qendëruar për rrjetin e brendshëm, çfarë do të thotë se siguria dhe mbrojtja e të dhënave të çdo punonjësi nga kërcënimet nëpërmjet internetit në rrjetin e brendshëm është e rrezikuar, për sa kohë mbi përdoruesit aplikohen përditësime të sistemeve dhe kufizime lokale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për ndërtimin dhe administrimin e një infrastrukturë të qendëruar të aksesimit në rrjet nga përdoruesit nëpërmjet implementimit të *Active Directory*, si një nga praktikat më të mira e parashikuar gjithashtu në standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe që ndikon në sigurinë e të dhënave qendrore dhe lokale të përdoruesve.

*Në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi gjurmimin elektronik të problematikave u konstatua se, KQZ nuk disponon ndonjë akt rregullativ apo udhëzues lidhur me ruajtjen, administrimin dhe analizimin e loge-ve gjeneruar nga pajisjet, sistemet, etj, e për pasojë këto detyra specifike mbi analizimin dhe gjurmimin elektronik të tyre nuk janë adresuar në pozicione specifike, sipas praktikave më të mira, standardeve të sigurisë si dhe pikës 4 shkronja a) të “Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të hartojë një akt rregullativ për administrimin e gjurmëve elektronike mbi pajisjet dhe sistemet që i shërbejnë monitorimit dhe auditimit, me qëllim analizimin, verifikimin dhe minimizimin e rrezikut në drejtim të sigurisë së të dhënave. Për këtë nevojitet të specifikohet qartë pajisjet dhe sistemet për të cilat do të ruhen gjurmë elektronike, vendi ku do të ruhen, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin në fuqi.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi procedurat e backup-it dhe vazhdimësisë së punës u konstatua se, në KQZ nuk janë:

- Analizuar dhe përcaktuar sistemet kritike, të dhënat kritike dhe kofidenciale të cilat i akseson në vazhdimësi apo përkohësisht sa herë është e nevojshme dhe në përputhje me aktivitetin e KQZ-ës;
- Ndërtuar plane të vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit si dhe plan të rimëkëmbjes në rast të një ndërprerje nga arsye të ndryshme që mund të jenë natyrore, njerëzore apo fizike;
- Procedura e ndjekur për kryerjen e backup nuk është pasqyruar apo dokumentuar në një dokument të brendshëm rregullues apo udhëzues, ku të jenë përcaktuar çfarë do të ruhet, si do të ruhet, periodiciteti dhe modeli i ruajtjes së tij.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 13-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të analizojë dhe përcaktojë sistemet kritike, të dhënat kritike dhe kofidenciale të cilat aksesohen nga institucioni përkohësisht apo në vazhdimësi. Gjithashtu, të hartohen planet e vazhdimësisë së biznesit dhe planet për backup në çdo drejtim të nevojshëm të teknologjisë dhe sistemeve informatike, për të minimizuar riskun e humbjes së të dhënave që ndikojnë në ecurinë dhe aktivitetin e institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, kur është e pamundur të merret shenja e gishtërinjve të zgjedhësit, operatorit i shfaqet një mesazh gabimi, me opsionet “Nënshkroi” dhe “Nuk nënshkroi”. Në rastin kur zgjedhësi nuk pranon të nënshkruajë tek lista fizike e zgjedhësve, operatori klikon tek opsioni “Nuk nënshkroi” dhe në këtë rast atij nuk i jepet fleta e votimit. Në manual nuk jepen udhëzime në rast se Operatori ka zgjedhur gabimisht opsionin:

- “Nuk nënshkroi” megjithëse zgjedhësi ka nënshkruar në listën fizike të zgjedhësve;
- “Nënshkroi” megjithëse zgjedhësi nuk ka nënshkruar në listën fizike të zgjedhësve.

Nga auditimi mbi konfigurimin e përdorimit të pajisjeve elektronike të identifikimit - PEI u konstatua se, Operatori ka të drejtë të zgjedhë “Jo”, megjithëse mbahen shënime në Librin e Protokollit të Mbledhjeve nga Sekretari dhe nënshkruhet po aty nga Sekretari dhe Operatori, për rastet që kanë pranuar të nënshkruajnë, në listën fizike të zgjedhësve.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të vlerësojë mundësinë për ndryshim parametrizimi në sistemin e ndërtuar mbi përdorimin e PEI, ku të hiqen opsionet që nuk lejohen të zgjidhen si dhe të plotësohen me udhëzimet përkatëse në manual ku të reflektohen ndryshimet që janë bërë në sistem.

*Në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi konfigurimet aktuale për identifikimin nëpërmjet pajisjeve PEI, u konstatua se zgjidhja e implementuar në zgjedhjet e periudhës 2021-2023, ku regjistrimi i gjurmës së gishtit është përdorur si nënshkrim biometrik, nuk ka mundur të parandalojë rastet si më poshtë:

- Votimin e dyfishtë, ku ka pasur raste në qendra votimi të ndryshme, të identifikohen votues me ID të njëjta, nga votues të identifikuar si administratë zgjedhore ose votues me Vendim Gjykatë, për të cilat janë identifikuar 43 raste;

- Votimin familjar ose votimin për një zgjedhës tjetër, ku ka pasur raste të kenë nënshkrim të njëjtë votues të identifikuar me ID të ndryshme, për të cilat ka patur 213 me përputhshmëri të mundshme në zgjedhjet e vitit 2023.

Për identifikimin elektronik të zgjedhësve, nuk janë përdorur të dhënat që gjenden në dokumentet e identifikimit elektronik që janë Karta dhe Pasaporta, të pajisura me të dhëna biometrike që krijohen, ruhen dhe ofrohen nga institucioni përgjegjës për prodhimin e dokumenteve biometrike. Për identifikim elektronik KQZ ruan gjurmën e gishtit që regjistrohet në ditën e votimit, për kontroll paszgjedhor me qëllim identifikimin elektronik “*a posteriori*”. KQZ për 256 raste e mësipërme, në zbatim të pikës 4, nenit 167/2 e Kodit Zgjedhor, ishte duke përgatitur materialin kallëzues për Prokurorinë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të marrë të gjitha masat e nevojshme për minimizimin deri në eliminim nëse do të jetë e mundur, të problematikave që rrjedhin nga identifikimi elektronik që janë votimet e dyfishta, gjurmëve me përputhshmëri të mundshme regjistruar për NID të ndryshme si dhe identifikimet manuale të cilat mbeten jashtë kontrollit pas zgjedhor.

*Në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi përfundimin e fazës së pilotimit për votimin elektronik, KQZ nuk ka kryer një vlerësim mbi përfitimet, mangësitë, vështirësitë si dhe nevojat për përmirësim të kësaj infrastrukture, me qëllim marrjen e sigurisë së arsyeshme se sistemet dhe pajisjet e teknologjisë të përdorura për votim elektronik pilot, i nënshtrohen parimeve që cilësohen dhe në nenin 22 “*Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje*”, të Kodit Zgjedhor mbi sigurinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përfundim të fazës së pilotimit për votimin elektronik, të analizojë dhe dokumentojë përfitimet, mangësitë, vështirësitë si dhe nevojat për përmirësim të infrastrukturës së ndërtuar për votimin elektronik, përpara investimeve të nevojshme për zgjedhjet e radhës që do të zhvillohen në vend.

*Në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi sistemin e Platformës për Raportimin Financiar u konstatua se në këtë sistem:

- Nuk lejohet shkarkimi i raporteve nga përdorues të KQZ-s, që kanë të drejta miratimi përpara se ata ti miratojnë ato;
- Nuk mundësohet gjenerimi i raporteve në format Excel apo formatet të tjera të përdorshme dhe të nevojshme me qëllim realizimin e statistikave të ndryshme;
- Nuk është bërë ende konfigurimi i rolit auditues në sistem;
- Drejtoria e IT-së në KQZ nuk ka njohuritë dhe kapacitetin profesional për mirëmbajtjen dhe administrimin e këtij sistemi dhe nuk është parashikuar marrëveshje e nivelit të shërbimit duke rritur riskun e ndërprerjes së shërbimeve dhe vazhdimësinë e punës në këtë sistem.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për sistemimin e problematikave të konstatuara në Platformë Elektronike të Raportimit Financiar - PERF, me qëllim përmirësimin e funksionaliteteve të ndërtuara aty që i shërbejnë auditimit dhe ofrimin të të dhënave në përmbushje të detyrimeve mbi transparencën e financimit të partive politike ndaj grupeve të interesit.

*Në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi sistemet që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, u konstatuan disa mangësi të njëjta që janë:

- Detyrat e administratorëve, të drejtat e tyre si dhe detyrimet nuk janë adresuar tek punonjës specifik të IT-s. Këto role janë caktuar në bazë të ndarjes së punëve brenda strukturës të TI;

- Nuk janë hartuar, miratuar apo zbatuar politika të caktuara mbi krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve të sistemit;
- Nuk janë zbatuar kritere që forcojnë fjalëkalimet, si gjatësia, përmbajtja, përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, sipas praktikave më të mira, standardeve si dhe pikës 4 “Kërkesat e Sigurisë” pika a. të rregullores për “Administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike” të miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet 18-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**14.1 Rekomandimi:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të marrë masa për hartimin, miratimin të akteve rregullativë mbi krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve të sistemeve që ka në përdorim. Gjithashtu, të dokumentohen, të aplikohen dhe të informohen përdoruesit mbi kriteret e ndryshme që janë aplikuar për forcimin e fjalëkalimeve, si gjatësia, përmbajtja, përsëritja dhe periodiciteti i ndryshimit, duke zvogëluar mundësinë për akses të paautorizuar.

*Në vijimësi*

---

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**